



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 238 prot.

Fushë-Arrëz, më 29. 01. 2025

VENDIM

Nr. 2, datë 27. 01. 2025

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR I BLOK- NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR
VITIN 2025.**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore.”, i ndryshuar; ligjit Nr.57/2019, datë 18.07.2019. “ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu IV, pika 2 e Vendimit Nr.955, datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar, Udhëzimit Nr.5, datë 23.02.2018 “ Mbi miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6%, VKM Nr.597, datë 04/09/2019 “ Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmen Ekonomike”, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz, në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga administratorët e ndihmës ekonomike të Bashkisë Fushë-Arrëz:

VENDOSI

Të miratojë kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok- ndihmës ekonomike deri në 6 % për vitin 2025.

Kriteret për përfitimin e masës së ndihmës ekonomike prej 6% për vitin 2025 janë:

1. Përfitojnë të gjitha familjet të cilat nuk rezultojnë përfituese në skemen e Ndhmës Ekonomike për pikë të pamjaftueshme.
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
3. Familje me shumë fëmijë.
4. Familje me fëmijë jetimë.
5. Familjet me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë dy ose më shumë fëmijë që vazhdojnë studimet jashtë vendbanimit.
6. Familje me kushte të vështira ekonomike që në përbërjen e tyre kanë anëtarë të paaftë.
7. Familje me kryefamiljare të veja apo të divorcuara.
8. Familje me dy ose më shumë anëtarë me vështirësi për t'u pranuar në tregun e punës.
9. Familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.
10. Familje me anëtarë me sëmundje kronike.
11. Familjeve një herë në tre muaj t'u bëhen riaplikim në skemën e NE.

Shtohet kriteri i miratuar nga këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 27.01.2025 ku thuhet:

12. Përfituesit nga çdo lloj kriteri, të masës së ndihmës ekonomike prej 6 %, duhet të jenë banues fizikisht në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 29. 01. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

